



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.3.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmerr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike dhe do të luajmë rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Gjakovës në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Mehmet Muçaj (Udhëheqës Ekipi), Faik Thaqi (anëtar i ekipit), dhe Elvir Krasniqi (anëtar i ekipit).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	7
2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak	12
4 Qeverisja	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	27
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	30
Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it.....	35


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Gjakovës për vitin 2014, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetaren e Komunës dhe stafin e saj për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit të datës 04.11.2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale me përjashtim të çështjeve në vijim:

Në nenin 13 Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit, Komuna kishte prezantuar vlerën e donacioneve gabimisht. Është prezantuar 55,000€ ndërsa duhet të jetë 204,739€;

Theksimi i çështjes


Dëshirojmë gjithashtu të përmendim faktin se 76,282€ të regjistruara në Investime Kapitale do të duhej të regjistroheshin si mallra dhe shërbime si dhe subvencione; vlerat e pasurive të regjistruara në PVF ishin jo të plota, pasi që në SIMFK nuk janë regjistruar të gjitha pronat komunale po ashtu situacionet e paguara si investime në vijim në shumë prej 299,564€, ishin regjistruar si projekte finale.


(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm, i vendosur nga komuna, funksionon në mënyrë efektive në disa fusha por ende kanë mbetur dobësi në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:





Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi për vitin 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Kryetarja. Përgjigjet lidhur me çështjet për të cilat nuk kemi mundur të pajtohemi janë dhënë në detaje në Aneksin III.

Ne e marrim si punë të kryer faktin që Kryetarja:

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/shkurt 2016 të inicoj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të komunës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shpreh opinionin:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para përgatitjes së PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurave vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetarja e Komunës dhe Zyrtaari Kryesor Financiar (ZKF), për PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm lidhur me PVF-të është se janë identifikuar disa gabime tek prezantimi i donacioneve, shpalosjeve, keq klasifikimi në kode jo adekuate, shpalosjet e pasurive. Ndërsa, sa i përket kërkesave të raportimit, ato ishin plotësuar.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale me përjashtim të çështjeve në vijim:

Në nenin 13 Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit, Komuna kishte prezantuar vlerën e donacioneve gabimisht. Është prezantuar 55,000€ ndërsa duhet të jetë 204,739€;

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë gjithashtu të përmendim faktin se 76,282€ të regjistruara në Investime Kapitale do të duhej të regjistroheshin si mallra dhe shërbime si dhe subvencione; vlerat e pasurive të regjistruara në PVF ishin jo të plota, pasi që në SIMFK nuk janë regjistruar të gjitha pronat komunale po ashtu situacionet e paguara si investime në vijim në shumë prej 299,564€, ishin regjistruar si projekte finale.

(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të dërguar me 04.11.2014, është identifikuar vetëm një rrezik domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive. Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar ka ndodhur për shkak se menaxhmenti edhe përkundër veprimeve për të regjistruar pasurinë në regjistrin kontabël, ende nuk kishte adresuar rrezikun.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1-Mos regjistrimi në SIMFK i të gjitha pasurive në pronësi të Komunës do të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për të dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurisë. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që vlera e pasurive në PVF të ishte e saktë dhe e plotë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar, sepse Menaxhmenti edhe përkundër veprimeve të marra gjatë vitit, nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm. Ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë jo të plota pasi që në SIMFK nuk janë të regjistruar të gjitha pasuritë (lokalet dhe pronat tjera). Po ashtu, pagesat e situacioneve për disa punime komuna i kishte regjistruar si projekte finale, dhe jo si investime në vijim. Vlera e tyre e regjistruar si projekte finale është 299,564€.

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë- Kryetarja e Komunës duhet të siguroj që të gjitha pasuritë në pronësi të komunës të regjistrohen në regjistrin kontabël (SIMFK) dhe në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna duhet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013 për PVF;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Nëse PVF janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF) brenda kornizës kohore;
- Nëse PVF janë nënshkruar nga Kryetarja (ZKA) dhe ZKF;
- Nëse PVF janë publikuar në gjuhën shqipe;
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe tek Ministri i MF gjatë vitit 2014.
- Raportet Operacionale (performancës); dhe
- Draft Plani dhe Plani Përfundimtar i prokurimit me kohë.

Komuna kishte përgatitur PVF me një vonës. Ato ishin dorëzuar në MF më 03.02.2015.

Çështja 2 - Procesi i përgatitjes së PVF - prioritet i lartë

E gjetura	Neni 13 raporti i ekzekutimit të buxhetit hyrja e parasë së gatshme, buxheti final të shtylla e donacioneve ishte prezantuar gabimisht. Ishte prezantuar 55,000€ ndërsa duhet të jetë 204,739€. Komuna kishte bërë pagesa të parregullta në vlerë 63,626€ nga kategoria investime kapitale vetëm në bazë të memorandumëve apo marrëveshjeve; Komuna e Gjakovës kishte keq deklaruar në PVF shpenzimet e investimeve kapitale ku nga kategoria e investimeve kishte paguar mallra dhe shërbime në vlerë prej 76,282€; dhe Shënimi 31 Përmbledhje e pasurive jo financiare kapitale, totali i pasurive me vlerë mbi 1,000€ në PVF ishte 40,982,000€ në vlerë neto. Në këtë vlerë nuk ishin përfshirë pronat komunale. Po ashtu, projekte kapitale ishin regjistruar si të përfunduara derisa ato në fakt janë investime në vijim.
Rreziku	Paraqitja jo e saktë e të dhënave në PVF dhe gabimeve të identifikuar në shumat e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës. Paraqitja e gabuar e buxhetit final të shtylla e donacioneve ka ndikuar në dhënien e Opinionit të Kualifikuar.
Rekomandimi 2	Kryetarja duhet t'i identifikojë arsyet për gabime në pasqyra dhe keq klasifikimet e identifikuar dhe të siguroj se proceset e rishikimeve nga menaxhmenti do të përmirësohen për PVF-të e vitit 2015 në mënyrë që të sigurohet se gabimet janë identifikuar dhe korrigjuar para se ato të dorëzohen në Qeveri.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar me kohë planin për adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak. Gjysma e rekomandimeve ishin adresuar, por mos adresimi i plotë i rekomandimeve ka rezultuar në ngritjen e çështjeve të ngjashme edhe në këtë raport auditimi.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 kishte rezultuar me 22 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2014, 11 rekomandime ishin adresuar plotësisht, 4 ishin adresuar pjesërisht, dhe 7 nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Rekomandimet e vitit paraprak nuk janë zbatuar plotësisht, sepse Komuna nuk ka një proces formal për të siguruar që të gjitha rekomandimet adresohen në mënyrë aktive dhe brenda afateve të përcaktuara kohore. Si të tilla, në këtë Raport të Auditimit përsëri janë ngritur çështjet për përmirësim të aktiviteteve të caktuara. |
| Rreziku | Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve menaxheriale dhe të tjera që ndërlidhen me identifikimin dhe regjistrimin e pronës komunale, mos mbajtja e evidencave të sakta për derivate dhe servise për çdo automjet, mos trajtimi i kontratave të qiradhënies së lokaleve komunale, mos hartimi i një plani të veprimit për adresimin e gjetjeve të auditimit të brendshëm, kanë rezultuar në dobësi të vazhdueshme organizative dhe në vlerë të dobët për para. Në veçanti, menaxhmenti ende nuk është në gjendje të merr nivelin e nevojshëm të sigurië nga Auditimi i Brendshëm mbi efektivitetin dhe efikasitetin e sistemeve kryesore financiare. Mundësia për themelimin të komitetit të auditimit të brendshëm duhet të shqyrtohet. |
| Rekomandimi 3 | Kryetarja duhet të sigurojë se një plan veprimi i rishikuar, për adresim të rekomandimeve të pa-adresuara të 2013 së bashku me rekomandimet e 2014, e përcakton një orar të qartë të zbatimit të tyre. Ky plan duhet t'i identifikoj afatet kohore, stafin përgjegjës dhe të përqendrohet fillimisht në fushat e rëndësisë më të madhe. |

4 Qeverisja

Konkluzion i Përgjithshëm

Komuna e Gjakovës nuk i ka adresuar gabimet materiale në PVF si dhe ato nuk ishin të një cilësie të duhur. Në kontekstin e sistemeve financiare, ne kemi identifikuar menaxhim pozitiv tek zvogëlimi i buxhetit për mallra dhe shërbime si dhe kontrolleve të forta mbi subvencione dhe transfere. Megjithatë ekzistojnë dobësi të kontrollit në sisteme të tjera financiare

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi procesin e planifikimit të të hyrave nuk janë të mira dhe nuk janë analizuar në mënyrë të qëndrueshme, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën e Gjakovës, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Për më shumë të dhënat janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	18,629,040	20,627,196	19,429,426	18,783,539	19,624,022
Granti i Qeverisë -Buxheti	15,584,040	17,079,550	16,755,270	16,254,860	16,448,318
Të bartura nga viti paraprak ²	0	297,907	296,632	333,255	491,511
Të hyrat vetanake ³	3,045,000	3,045,000	2,348,116	2,074,262	2,449,266
Donacionet e brendshme	0	156,015	13,372	110,646	199,222
Donacionet e jashtme	0	48,724	16,036	10,516	35,705

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,998,156€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të brendshme dhe të jashtme (204,740€) të hyrave të bartura nga viti paraprak (297,907€), dhe rritja e grantit qeveritar për shkak të rritjes së pagave (1,495,509€).

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Komuna ka realizuar një nivel të kënaqshëm të buxhetit të përgjithshëm në 2014, prej 94%. Një shkallë e njëjtë ishte edhe në vitin e kaluar.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimet	2012 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	18,629,040	20,627,196	19,429,426	18,783,539	19,624,022
Pagat dhe Mëditjet	10,272,630	11,778,036	11,759,147	10,149,794	10,196,103
Mallrat dhe Shërbimet	1,572,972	1,640,445	1,404,276	1,522,469	1,708,009
Shërbimet komunale	733,185	824,234	716,377	650,300	649,066
Subvencionet dhe Transferet	526,000	532,825	509,556	459,649	1,069,566
Investimet Kapitale	5,524,253	5,851,656	5,040,070	6,003,327	6,001,278

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Shpenzimet e të hyrave vetjake të cilat kanë qenë 696,000€ ose 23% më pak se shuma e planifikuar – kjo në veçanti ndikon në dinamikën e realizimit të projekteve të planifikuara për t'u financuar nga burimet vetjake;
- Dallimi i buxhetit final i pagave krahasuar me atë fillestar shënon një rritje prej 15%, e bërë me vendim të Qeverisë, për të mbuluar rritjen e pagave prej 25% që nga prilli i vitit 2014.
- Është shpenzuar vetëm 86% e buxhetit për Mallra dhe Shërbime. Komuna kishte mbajtur në mënyrë aktive nivelin e ekzekutimit të kësaj kategorie në nivel të zakonshëm, në mënyrë që të adresojë shkurtimin e buxhetit prej 15% në Mallra dhe Shërbime për të gjitha organizatat. Ky shkurtim nuk është reflektuar në buxhetin final, por në alokimet që i janë bërë Komunës; dhe
- Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale gjatë vitit 2014, vetëm 86% e buxhetit ishte shpenzuar.

Çështja 4 - Pagesa e vendimeve gjyqësore dhe ekzekutimi i pagesave nga Thesari - prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2014 kishte shpenzuar 244,559€ në bazë të vendimeve gjyqësore dhe 1,031,173€ ishin ekzekutuar nga Thesari (MF) në bazë të nenit 39.2 të LMFP. Këto mjete ishin shpenzuar për të paguar obligimet e viteve të kaluara të cilat ishin bartur në vitin 2014.
- Rreziku** Ekzekutimi i pagesave të tilla ndikon në mos ruajtjen e ekuilibrit buxhetor dhe rritë rrezikun që projektet e planifikuara me projeksionet fillestare të mos realizohen fare.
- Rekomandimi 4** Për t'iu shmangur situatave të përmendura më lart, Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e hartimit të buxhetit, të gjitha detyrimet e mbetura janë parashikuar me buxhet, si dhe të forcojë disiplinën financiare që të gjitha obligimet të paguhen me kohë.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat	3,045,000	3,045,000	2,731,645	2,370,064	2,778,027

Të hyrat vetjake për vitin 2014 në krahasim me planin janë realizuar në nivelin rreth 90%, dhe kanë shënuar rritje prej 361,581 në krahasim me vitin 2013, por kanë pësuar një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2012.

4.2 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Komuna e Gjakovës nuk ka të vendosura kontrole të mjaftueshme që ndërlidhet me mbledhjen e të hyrave vetjake. Më tutje, ekziston nevoja për përmirësimin e disa proceseve për ta mbështetur saktësinë dhe plotësinë e mbledhjes së të hyrave. Në procesin e mbledhjes (menaxhimin) e të hyrave vetjake, ne kemi identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 5- Dhënia e pronës komunale me qira - prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Gjakovës në vitin 2014 nuk kishte zbatuar ankand publik për dhënien e lokaleve komunale në shfrytëzim afatshkurtër. Në gjashtë (6) mostra, kontratat e qirasë mes Komunës dhe shfrytëzuesve ishin me afate të skaduara, përderisa ato shfrytëzoheshin ende, dhe pa i kryer obligimet ndaj komunës.

Në katër mostrat e përzgjedhura, kemi vërejtur se obligimet e papaguara të këtyre shfrytëzuesve për katër vitet e fundit ishin 45,449€, prej të cilave 8,496€ për vitin 2014.

Rreziku Shfrytëzimi i pronave komunale në mungesë të kontratave valide me komunën, përveç që është në kundërshtim me ligjin, rrit rrezikun që këta shfrytëzues të refuzojnë obligimin financiar ndaj komunës dhe këto të hyra mos të mbledhen kurrë.

Rekomandimi 5 Kryetarja duhet të rishikoj mundësinë që para dhënies me qira të lokaleve dhe pronës komunale të zbatoj procedurat e ankandit publik, dhe për shfrytëzuesit e pronave që nuk kanë kryer obligimet financiare ndaj komunës, të ndërmerr masa për mbledhjen e borxheve të mbetura.

Çështja 6 - Planifikimi i dobët i të hyrave në tatim në pronë - prioritet i mesëm

E gjetura Komuna kishte planifikuar të hyrat nga tatimi në pronë në shumë prej 1,470,000€ derisa faturimin për vitin 2014 e kishte 1,634,000€. Inkasimi i të hyrave nga tatimi në pronë ishte 1,264,759€. Nga kjo shihet se procesi i planifikimit nuk i është nënshtruar një analize të qëndrueshme. Borxhet (llogaritë të arkëtueshme) në fund të vitit 2014 ishte 7,006,415€. Prej tyre 2,906,693€ janë borxhe të ndërmarrjeve shoqërore dhe 4,099,722€ borxhe të qytetarëve.

Rreziku Mungesa e kontroleve efektive në menaxhimin e të hyrave vetjake do të vazhdojë të rezultojë me shkallë të ulët të inkasimit të tyre. Si pasojë, komuna do të ballafaqohet me mundësi të reduktuara për realizimin e objektivave në ofrimin e shërbimeve dhe në investimet kapitale të financuara nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi 6 Kryetarja duhet të sigurojë se do të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse për ngecjet në zbatimin e rekomandimit për eliminimin e dobësive në menaxhimin e të hyrave vetjake. Një zgjidhje duhet të ofrohet dhe të vendosen kontrole të qëndrueshme që sigurojnë një planifikim të mirëfilltë dhe inkasim efektiv të të hyrave vetjake të komunës.

Çështja 7 -Vonesa në deponimin e mjeteve në bankë – prioritet i mesëm

- E gjetura** Në drejtoratin e shëndetësisë kemi vërejtur se mjetet të cilat mbledhen nga participimet (nën 10€) nuk dërgohen te arka kryesore brenda dite, të cilat duhet të depozitohen në llogarinë bankare. Vonesat në depozitim të mjeteve në llogarinë bankare ishin deri në 20 ditë.
- Rreziku** Mos dërgimi i mjeteve në kohë te arka kryesore rritë rrezikun e humbjes dhe të keqpërdorimit të tyre. Përveç kësaj, kjo është në kundërshtim me rregulloren 03/2010 për të hyrat vetjake.
- Rekomandimi 7** Kryetarja duhet të siguroj që mjetet e mbledhura nën 10€ të dërgohen tek arka në mënyrë që ato mjete të deponohen në llogarinë bankare të komunës.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Komuna e Gjakovës për vitin 2014 për kategorinë Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime kishte shpenzuar 7,160,683€. Prej tyre kemi testuar 40 pagesa në vlerë prej 1,403,451€ dhe 16 mostra për aktivitetet e prokurimit në vlerë 1,728,261€.

Testimet tona kanë vënë në pah mangësitë në vijim:

Çështja 8 - Dobësitë sistematike në prokurim - prioritet i lartë

- E gjetura** Te projekti “mirëmbajtje e rrugëve të asfaltuara, sanimin e gropave” komuna kishte lidhur kontratë kornizë me Operatorin Ekonomik (OE) të pa përgjegjshëm. OE i përzgjedhur nuk kishte ofruar dëshmi për pronësinë e pajisjeve të domosdoshme për realizimin e projektit. Njësia kërkuese nuk ka bërë përllogaritjen e vlerës së parashikuar të kontratës në mënyrë formale, siç e kërkon neni 9 i LPP;
- Në projektin “Ndërtimi i serrave” në vlerë 37,919€, komuna kishte shpërblyer me kontratë OE të pa përgjegjshëm, pasi që OE fitues nuk kishte ofruar dëshmi për qarkullim financiar për tri vitet e fundit;
- Për asfaltimin e rrugës Fan S. Noli- Tefik Çanga, në vlerë 26,440€, OE fitues nuk kishte ofruar dëshmi për pronësinë e pajisjeve të domosdoshme për realizimin e projektit (librezat); dhe
- Gjithashtu, në prokurimin “Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve dhe drunjëve dekorativ”, OE fitues nuk kishte ofruar kontratat dhe referenca për tri vitet e fundit, si dhe në vërtetimin e ATK-së, evidentohet si debitor ndaj tatimeve.
- Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të kërkuara gjatë vlerësimit të ofertave ka rezultuar me shpërblim të kontratave ndaj Operatorëve Ekonomik të pa përgjegjshëm. Fakti që OE nuk i kishin përmbushur kriteret e kërkuara në dosje të tenderëve, rritë rrezikun e pa përgjegjshmërisë në procesin e ekzekutimit të kontratës. Kjo gjithashtu, dëmton konkurrencën dhe arritjen e vlerës për para.
- Rekomandimi 8** Kryetarja duhet të shqyrtoj arsyet pse dështimet e tilla kanë ndodhur në proces dhe të siguroj që zhvillimi i procedurave të prokurimit bëhet konform kërkesave të LPP në mënyrë që të shpërblehen me kontratë vetëm OE të përgjegjshëm.

Çështja 9 - Dobësitë jo sistematike në prokurim- prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna kishte lidhur kontratë më 04.11.2013 “Për ndërtimin e urës në Fierz” në vlerë prej 8,975€. Afati për përfundimin e punimeve ishte 8 ditë pune derisa punimet ishin kryer më 11.08.2014, me një vonesë prej më shumë se nëntë muaj;
- Për “ndërtimin e zyrës së vendit në Rugovë”, komuna kishte lidhur kontratë në vitin 2011 në vlerë 24,094€ dhe punët ishin paraparë të realizohen për 78 ditë. Komuna në vitin 2014 kishte paguar 10,000€. Projekti është përfunduar në vitin 2014 derisa obligimi nga komuna për 7,094€ ende nuk ishte kryer; dhe
- Komuna Gjakovës kishte bërë vazhdimin e kontratës kornizë për sigurimin e objektit të Komunës në kundërshtim me nenin 38, paragrafi 2 të LPP sipas së cilit kontratat kornizë nuk mund të ripërtërihen. Vazhdimi i kësaj kontrate ishte bërë për një muaj.
- Rreziku** Vonesat në ekzekutimin e punëve tregojnë se ekzekutim i kontratave nuk ishte menaxhuar si duhet. Vazhdimi i kontratave kornizë, eliminon konkurrencën e lirë dhe komuna mund të paguaj çmime më të larta nga ato që ofron tregu.
- Rekomandimi 9** Kryetarja duhet të siguroj që procesi i menaxhimit të kontratave të jetë më efektiv dhe për të gjitha vonesat, të parashikohen dhe zbatohen penalet, si masë për implementimin e kontratës, si dhe të mos bëhet vazhdimi i afatit të kontratave publike kornizë.

4.3.2 Shpenzimet tjera

Ne kemi rishikuar edhe shpenzimet e derivateve dhe shpenzimet për mirëmbajtje dhe servisim të veturave zyrtare. Ne kemi vërejtur se shpenzimet për derivate ishin zvogëluar për 56% krahasuar me vitin paraprak (158,118€ ishin shpenzuar në vitin 2013 dhe 101,108€ janë shpenzuar në vitin 2014). Po ashtu, edhe shpenzimet e servisimit ishin zvogëluar për 48% krahasuar me vitin e kaluar (31,333 € ishin shpenzuar në vitin 2013 ndërsa 21,151€ janë shpenzuar në vitin 2014). Më tutje kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

Çështja 10 - Servisimi i veturave private me fondet buxhetore të komunës - prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Gjakovës kishte bërë servisimin e veturës me targa të regjistrimit 01-395-BH në vlerë prej 872€. Vetura e servisuar është veturë private dhe nuk gjindet në regjistrat e pasurisë së Komunës. Pas dorëzimit të draft raportit, u sqarua se vetura ishte pronë e Mabetex Holding në shfrytëzim të Kryetares së Komunës. Pas diskutimit të këtij rasti me Kryetaren e komunës, më 27.04.2015, paratë (872€) janë kthyer në llogarinë e komunës.

Rreziku Dështimet në kontrollet financiare kanë shkaktuar që paratë e shpenzuara për servisimin e kësaj veture të jenë në kundërshtim flagrant me rregulloren financiare mbi shpenzimin e parave publike, dhe rasti si i tillë, paraqet keqpërdorim tipik të parasë publike.

Rekomandimi 10 Kryetarja duhet të jetë e vëmendshme në shpenzimin e fondeve publike për nevoja të servisimit të automjeteve private. Kryetarja duhet ta rishikoj nëse ky rast paraqet rast të izoluar apo veprime të tilla kanë ndodhë edhe me automjetet tjera private. Në rast se ka edhe pagesa tjera për këso qëllimesh, atëherë duhet të inicohen masa të menjëhershme të përgjegjësisë.

Çështja 11 - Pagesa përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit - prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2014 kishte nënshkruar memorandume të bashkëpunimit. Ne rishikuam memorandumet dhe vërejtëm çështjet si në vijim:

Komuna me 06.08.2014 kishte lidhur Memorandum Mirëkuptimi me Europën e Kosovës për organizimin e konkursit arkitektonik urbanistik në komunën e Gjakovës. Sipas memorandumit, ky projekt pritet të fillojë në vitin 2015. Memorandumi parasheh që komuna të paguaj 60,000€ në dy këste, 30,000€ në vitin 2014 dhe 30,000€ në vitin 2015. Komuna më 15.09.2014 kishte paguar 30,000€ në llogari të Europës së Kosovës nga kategoria investime kapitale, pa faturë apo ndonjë raport për punët e kryera

Komuna e Gjakovës më 02.09.2014 kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi me CHWB (Fondacioni Suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij) dhe Fondacioni Behgjet Pacolli. Qëllimi i marrëveshjes ishte rregullimi i segmentit të rrugës Ismail Qemajli. Bazuar në marrëveshje Komuna participon 33,626€, Fondacioni Behgjet Pacolli 5,000€ dhe CHWB 3,868€. Komuna obligohet t'i bartë mjetet 38,626€ (33,626€+5000€) në xhirollogarinë e CHWB në dy këste. Fondi Behgjet Pacolli sipas marrëveshjes duhej t'i bart mjetet në llogari të Komunës, mirëpo këto mjete nuk ishin bartur në llogari.

CHWB është përgjegjëse për realizimin e procesit të prokurimit, hartimin e planit operacional në konsultim me Komunën dhe nuk bart përgjegjësinë për rrugën pas përfundimit të projektit. Marrëveshja nuk ishte në pajtim me ligjin e prokurimit publik neni 4 pika 2 sepse nëse projekti financohet apo subvencionohet 50% ose më shumë nga komuna, komuna konsiderohet autoritet kontraktues dhe procedurat e prokurimit duhet të bëhen në pajtim me ligjin e prokurimit publik. Për këtë projekt komuna ka participuar me 79% dhe është dashur që procedurat e prokurimit t'i udhëheq vetë e jo CHWB. Obligimin e vet prej 33,626€, komuna e kishte paguar, pa pjesën e fondacionit Behgjet Pacolli. Pagesa e fundit prej 21,857€ ishte bërë edhe pse në raportin e pranimit teknik vërehen disa mangësi në realizimin e projektit.

Rreziku

Pagesat e bëra në avans para datave të projektit, të pambështetura nga kontratat efektive mund të rezultojnë në humbje financiare për Komunën. Pagesat për partnerët, të pa mbështetura nga informatat e hollësishme në bazë të shpenzimeve, mund të rezultojnë në mosarritjen e objektivave dhe potencialisht konsiderohen të parregullta. Marrja e rolit të agjentit nga ana e donatorit në zhvillimin e procedurave të prokurimit, rrit rrezikun e abuzimit me procesin që mund të rezultojë me cilësinë e dobët, madje edhe me dështimin e projektit.

Rekomandimi 11 Kryetarja duhet të sigurojë se nuk do të përsëritet një praktikë e tillë e paradhënieve, pos nëse është bërë rishikim rigoroz ku janë përjashtuar rreziqet që i shoqërojnë pagesat e tilla. Marrëveshjet për bashkëfinancim duhet t'i reflektojnë aranzhimet kontraktuale të cilat i ofrojnë komunës monitorim efektiv dhe kjo duhet të aplikohet sa më shumë që të jetë e mundur te marrëveshjet ekzistuese.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 11,778,036€ ndërsa shpenzimi për vitin 2014 ishte 11,759,147€, apo 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientët janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna e Gjakovës për vitin 2014 kishte planifikuar buxhetin 526,000€ ndërsa kishte shpenzuar 509,556€ apo 97%.

Kuvendi Komunal i Gjakovës ka aprovuar me ndryshime Rregulloren e brendshme për ndarje të subvencioneve me 07.07.2014.

Ne kemi testuar 15 mostra në vlerë 146,735€ dhe identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja 12 - Dhënia e subvencioneve - prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2014 kishte subvencionuar klubin futbollistik Vllaznimi me 53,527€. Kjo ishte në kundërshtim me nenin 9 të Rregullores së Brendshme për Subvencione i cili saktëson se personi juridik mund të përfitoj subvencione komunale gjatë një viti vlerën deri në 10,000€;

Komuna e kishte subvencionuar në shumë 6,600€ OJQ Active Society for youth Development për organizimin e konferencës së donatorëve. Subvencioni i kësaj OJQ ishte në kundërshtim me kërkesat e nenit 7 të rregullores së brendshme komunale që përcakton se personi juridik duhet t'i plotësonte këto kritere: certifikata e regjistrimit si person juridik dhe qarkullimi vjetor financiar. Përfituesi nuk i plotësonte këto kritere.

Rreziku Dhënia e subvencioneve pa përfillur kërkesat e rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve, rritë rrezikun që subvencionet të ndahen pa kritere dhe të mos arrijnë qëllimin e caktuar.

Rekomandimi 12 Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve për zbatimin e procedurave për subvencione dhe të siguroj se ndarja e tyre do të bëhet në pajtim të plotë me kërkesat e rregullores së brendshme.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se komuna ka vazhduar procesin e regjistrimit të pasurive në SIMFK dhe kishte bërë një progres krahasuar me vitin e kaluar. Në PVF e vitit 2014, komuna ka prezantuar pasuri neto në vlerë 40,981,913€ që krahasuar me vitin 2013 kishte 38,469,845€, një rritje prej 2,512,068€.

Aktiviteti i komunës në regjistrimin e pasurive është domethënës ngase vetëm në vitin 2014 ka arritur të formoj komisionet për verifikimin e pronave komunale dhe komisionin për verifikimin e banesave dhe lokaleve komunale. Komisioni për verifikimin e pronave komunale ka përgatitur raportin përfundimtar, derisa komisioni për verifikim të banesave dhe lokaleve ka përgatitur një draft dhe është në proces të verifikimit.

Çështja 13 - Mos regjistrimi i plotë i pasurisë - prioritet i lartë

E gjetura Regjistri i pasurisë në Komunën e Gjakovës nuk është i plotë për faktin se testimi ynë ka rezultuar se lokalet komunale nuk janë të përfshira në regjistrin kontabël të pasurisë. Përveç kësaj komuna ende nuk ka arritur të regjistroj pagesat për projektet e këtij viti si investime në vijim.

Drejtorati i Shëndetësisë ende nuk ka arritur të regjistroj pasuritë më të vogla se 1,000€ në programin e E-pasurisë.

Rreziku Mos regjistrimi i plotë i të gjitha pasurive të cilat janë në pronësi të komunës, rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurive dhe paraqitjes jo të drejt të vlerës së pasurisë. Në mungesë të evidencave të duhura pasuritë mund t'i ekspozohen humbjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre.

Rekomandimi 13 Kryetarja duhet të siguroj se një proces gjithëpërfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës.

4.4.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrimi

Llogaritë e arkëtueshme në Komunën e Gjakovës në fund të vitit 2014 ishin 8,805,000€ dhe krahasuar me vitin paraprak (5,370,000€), ato janë rritur për 3,435,000€ apo rreth 64%. Këto llogari të pa mbledhura janë nga tatimi në pronë, taksat në firmë (këtë taksë komuna e ka hequr në Qershor të vitit 2014), dhënia e pronave komunale me qira, etj.

Çështja 14- Trajtimi i llogarive të arkëtueshme -Prioritet i lartë

E gjetura Rritja e llogarive të arkëtueshme për 3,435,000€ në vitin 2014, në krahasim me një vit më parë, ishte si rezultat i prezantimit jo të plotë të këtyre llogarive nga tatimi në pronë në PVF 2013, ku kamata dhe dënimet nuk ishin përfshirë në totalin e borxheve. Përveç kësaj, Komuna e Gjakovës për vitin 2014 kishte ngarkuar me borxhe shfrytëzuesit e pronave komunale të cilëve u kishin skaduar kontratat.

Rreziku Mos arkëtimi i borxheve mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të shpenzimeve. Politikat jo efikase të komunës në trajtimin e këtyre llogarive, kanë rezultuar në rritjen e tyre nga viti në vit dhe kjo rritë rrezikun e mos realizimit të projekteve komunale të planifikuara nga burimet vetjake.

Rekomandimi 14 Kryetarja duhet të sigurojë iniciimin e një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, mundësive reale për inkasim dhe duhet të siguroj vendosjen e një plani strategjik për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme.

4.4.3 Trajtimi i borxheve

Çështja 15- Trajtimi i borxheve - prioritet i mesëm

E gjetura Pasqyra e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2014 ishte 3,269,028€ ku nga kjo shumë obligime financiare ishin 1,361,379€ dhe obligime sipas raporteve të pranimi të punëve 1,907,000€. Pjesa më e madhe e këtyre obligimeve ishte bartur nga vitet paraprake.

Rreziku Obligimet e larta të komunës ndaj operatorëve prishin ekuilibrin buxhetor të komunës, me rrezikun potencial që projektet e parapara të mos realizohen.

Rekomandimi 15 Kryetarja duhet të shqyrtoj në mënyrë të hollësishme të gjitha obligimet e tanishme dhe ato të trashëguara, dhe të njëjtat të përfshihen me buxhetin vjetor, në mënyrë që të parandalohet mundësia e pagesës nga ana e Thesarit apo vendimeve gjyqësore.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga një auditor i cili ushtron edhe pozitën e drejtorit të njësisë. NJAB kishte hartuar planin vjetor i cili ishte modifikuar nga Kryetarja e komunës. NJAB-i kishte planifikuar 5 raporte të auditimit, të cilat edhe i kishte përfunduar gjatë vitit, dhe raporte tjera me kërkesë të menaxhmentit. Të gjitha raportet kishin si subjekt rishikimi aktivitetet e vitit 2013.

Çështja 16 - Mos fokusim i NJAB-it në vitin aktual- prioritet i lartë

E gjetura Qasja e auditimit të brendshëm nuk kishte një qasje parandaluese para se gjërat të ndodhin. Kontributet e ofruara nga Auditimi i brendshëm nuk i kanë ndihmuar menaxhmentit të kuptoj veprimin dhe efektivitetin e kontrolleve për të marr masat eventuale përmirësuese dhe si rezultat Komuna e Gjakovës kishte angazhuar një kompani private për auditime të shpenzimeve të vitit 2012 dhe 2013;

Ne nuk kemi mundur të mbështetemi në punën e NJAB, ngase objektivat, qasja e testimit dhe mbulueshmëria e auditimit, nuk janë në përputhje me kërkesat e auditimit të jashtëm dhe nuk adresojnë të gjitha fushat me rrezik domethënës.

Konkluzionet më sipër sugjerojnë mungesë vëmendjeje për të ofruar përfitimet maksimale që një sistem i auditimit të brendshëm mund t'i jap Komunës së Gjakovës

Komuna akoma nuk e ka themeluar komitetin e auditimit të brendshëm.

Rreziku Fokusi i auditimit të brendshëm në ndjekjen e rasteve pasi ato të kenë ndodhur, nuk i shton vlerë menaxhimit financiar dhe kontrolleve të brendshme që aplikon komuna.

Rekomandimi 16 Kryetarja duhet të siguroj që fokusi i auditimit të brendshëm të jetë shqyrtimi i aktiviteteve aktuale dhe parandalimi i gabimeve dhe parregullsive, dhe jo rishikimi i tyre pasi ato të kenë ndodhur. Gjithashtu, çështja e themelimit të Komitetit të Auditimit në vitin 2015, duhet të merret në konsiderim.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Pasuritë	Kryetarja duhet të identifikoj veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojnë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014			Pa adresuar
2. Pasqyrat financiare	Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive. Menaxhmenti ka nevojë të monitoroj zbatimin e kësaj kërkesë. Klasifikimi i gabuar i kodeve ekonomike, gjithashtu, pasqyron shpenzimet në mënyrë të pa saktë dhe regjistrimet si të tilla duhet të jenë në pajtim me Planin kontabël të Thesarit.		Pjesërisht	
3. Adresimi i rekomandimeve	Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se fillimisht do të përgatisë një planë të veprimit ku do të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar në fushat më të rëndësishme.	Adresuar		
4. Dobësitë e kontrollit të Menaxhmentit të lartë	Kryetarja e Komunës duhet të rishikojë formën e raportimit tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të paraqesë një zgjidhje të përshtatshme deri në fund të vitit.	Adresuar		

5.Ekzekutimi i Buxhetiti	Kryetarja e Komunës duhet të vendos një qasje me qëllim të përmirësimit të planifikimit buxhetor. Para se të vendosen zërat buxhetor, komuna duhet të analizoje me kujdes dhe me objektivitet se cilat projekte janë prioritete dhe cilat prej tyre kanë gjasa reale të realizohen. Përveç kësaj, Kryetarja e komunës duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore, sidomos të kategoria e investimeve kapitale, si dhe subvencionet dhe transferimet në mënyrë që të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat potenciale		Pjesërisht.	
6.Mos planifikimi mire i buxhetit	Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se gjatë procesit të planifikimit të përfshihen të gjithë akterët e nevojshëm dhe të gjitha informacionet relevante në mënyrë që bëhet një planifikim i qëndrueshëm buxhetor.	Adresuar		
7. Tatimi në pronë	Kryetarja e Komunës duhet të rishikojë politikat aktuale dhe të propozojë masat dhe veprimet konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat administrative dhe gjyqësore. Po ashtu, Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se çështja e anketimit të pronave do të mundësohet si pjesë e aktiviteteve të rregullta, në mënyrë që të bëhet futja e të gjitha pronave të reja në data bazën e tatimit në pronë.		Pjesërisht	
8.Lejet e ndërtimit	Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se kontrole shtesë mbi kalkulimin e tarifave të ndërtimit janë vendosur, dhe baza mbi të cilat janë bërë kalkulimet, është e qartë dhe e dokumentuar.	Adresuar		

9. Pronat e dhëna me qira-të hyrat	Kryetarja e Komunë duhet të zbatoj një proces rishikimi të kontratave të qiradhënies së pronave, si dhe gjendjen e objekteve/pronave që shfrytëzohen pa kontrata formale me komunën. Regjistrimi të gjitha pronave dhe ngarkesave shoqëruese, duhet të shqyrtohet të paktën çdo gjashtë muaj.			I pa adresuar
10. Taksat në biznes	Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se departamenti i të hyrave do të krijoj një bazë të plotë të dhënash, e cila do të gjeneroj raporte të sakta mbi gjendjen reale të ngarkesave ndaj debitorëve, si dhe të merr masa adekuate për reduktimin e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat ligjore.	I adresuar		
11. Shpenzimet Prokurimi	Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se në të gjitha rastet e prokurimit, vlerësimi i ofertave nga ana e komisioneve bëhet në mënyrë objektive dhe në mënyrë strikte respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit.			I pa adresuar
12. Shpenzimet	Kryetarja e Komunës duhet që të siguroj se kontrole të duhura janë rivendos në mbajtjen e saktë të evidencave për shpenzimet e derivateve dhe servisimeve për secilin automjet zyrtarë veçmas. Më tej, Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë që rasti i furnizimeve dhe pagesave për goma të hetohet plotësisht dhe të ndërmerren masat adekuate për këtë rast.			Pa adresuar
13. Nënshkrimi i disponueshmërisë se mjeteve.	Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i të gjeturave të auditimit në të cilat proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, si dhe të përcaktojë se pse kanë ndodhur dështimet në to. Veprimet/proceset e duhura duhet të implementohen për të siguruar se dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.	I adresuar		

14.Furnizim me tonerë	Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se njësitë kërkuese furnizohen me artikuj që janë të domosdoshëm për veprimtarinë e rregullt. Të gjitha hyrje-daljet e depos duhet të jenë të evidentuara qartë, sidomos për artikujt në vlera të larta.		Pjesërisht	
15.Pagat-Procedurat e rekrutimit	Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se janë respektuar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe emërimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.	I adresuar		
16. Pagat	Kryetarja e Komunës duhet të ndërmerr veprimet e duhura për ndërprerjen e praktikave të tilla, si dhe të analizoj nëse ky është vetëm një rast i izoluar apo kjo është një dukuri sistematike.	I adresuar		
17.Subvencionet	Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se janë zbatuar të gjitha procedurat dhe kriteret për dhënien e subvencioneve, para se të bëhet ndarja e tyre. Mjetet e planifikuara për subvencione dhe transfere duhet të shpenzohen në bazë një rregullore të brendshme ku specifikohen qartë veprimtaritë të cilat mund të subvencionohen			I pa adresuar
18.Subvencione	Kryetarja e Komunës duhet të siguroj që të behën MIM me përfituesit duke i obliguar ata të raportojnë në mënyrë që të sigurohet që subvencionet kanë arritur objektivat për të cilat janë dhënë	I adresuar		
19.Subvencione	Kryetarja e Komunës duhet të rivendos kontrolle shtesë me rastin e dhënies së bursave, në mënyrë që komisioni për vlerësimin e aplikuesve të jetë i paanshëm, i drejtë dhe transparent në përzgjedhjen e përfituesve.	I adresuar		

20.Pasuritë	Kryetarja e Komunës duhet të siguroj që sa më parë të formoj një komision kompetent i cili do të bënte vlerësimin dhe inventarizimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive jo financiarë që janë në pronësi të komunës. Gjithashtu, menaxhmenti duhet të monitoroj edhe rezultatet e vlerësimit.			I pa adresuar
21.Trajtimi I borgjeve	Kryetarja e Komunës duhet të siguroj se me rishikim buxheti të kërkoj fonde shtesë për mbulimin e këtyre detyrimeve. Problemi si i tillë duhet të diskutohet me MF dhe Qeverinë. Gjithashtu, një monitorim i buxhetit duhet të bëhet në baza të rregullta për të siguruar se problemet e identifikuar në programin e PIP-it të prezantuara në kapitullin 4.4.1 të këtij raporti do të menaxhohen në pajtim me kërkesat ligjore.	Adresuar		
22.NJAB	Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë se do të bëjë një plan veprimi se si mendon që gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm të adresohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit. Po ashtu, duhet të rishikoj mundësinë që NJAB do të plotësohet me stafin shtesë sipas kërkesave të udhëzimit administrativ nr. 23/2009. Kryetarja e Komunës duhet po ashtu të sigurojë themelimin e Komitetit të Auditimit brenda afateve optimale.			I pa adresuar

Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Te gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e ZAP-it
Çështja 2:	Jo	Hyrja e parasë se gatshme nga donatorët 54.929,62€ duhet të jete 204.739€ sipas Auditorit. Por këtu kemi të bëjmë me të hyrat nga donatorët për vitin 2014 e jo për të hyrat e bartura nga vitet paraprake sepse ato janë paraqit në Pasqyra Financiare të viteve paraprake (kur janë realizuar)-Dëshmi kopjen e skanuar të procedurës mbi Përgatitjen e Pasqyrave Financiare nga MF-ve, ku tregon se duhet të paraqitet vetëm grandet e përfituar gjatë vitit kalendarik por jo edhe vlerat e bartura	Buxheti final në SIMFK për donacione është 204,739€ prandaj kjo vlerë është dashtë të prezantohet në PVF. E gjetura dhe konkluzioni ynë mbetet pasi që komuna nuk ka dëshmi që e dokumenton të kundërtën.
Çështja 7:	Jo	Arsyetim lidhur me të gjeturat: 7- Vonesa në depozitimin e mjeteve në bankë – prioritet i mesëm. Shpjegim paraprak.- Kujdesi Parësorë Shëndetësorë- KPSH (apo Mjekësia primare) në Komunë të Gjakovës ofrohet në 27 objekte. Bashkangjitur kësaj shkrese është paraqitur një tabelë me emrat e Institucioneve të KPSH-së dhe largësinë në kilometra nga objekti i institucionit qendrorë (apo vendndodhjes së administratës – objekti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunë të Gjakovës- QKMF). Tabela, në kolonën e dytë paraqet largësinë në kilometra në njërin drejtim dhe në kolonën e tretë paraqet numrin e gjithmbarshëm të kilometrave të kaluara për të u mbledhur bashkë-pagesat brenda një dite. Nga tabela ju mund të shihni se për mbledhjen (grumbullimin) e mjeteve nëpër Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF), të cilat brenda një dite nuk mund të mbledhin më shumë se 10 € do të duhej që të ecet (udhëtohet me makinë) rreth 152 km brenda një dite.	Ky është vetëm arsyetimi i Komunës pasi që rastet që ne kemi pasur për mostër janë QMF-të që gjenden në Gjakovë. E gjetura dhe konkluzioni ynë mbetet.

		Bazua në llogaritjet tona (numrin e vogël të pacientëve – kur nuk ka epidemi, etj.) ndodhë që ne nuk do të kishim mund me i arsyetua shpenzimet e mbledhjes së këtyre bashkë-pagesave. Me fjalë të tjera këto shpenzime (të udhëtimit) nuk do të e justifikonin kosto-efektivitetin e mbledhjes së bashkë-pagesave. 2. QKMF dëshmon se të hyrat e mbledhura nga vetë Institucioni – objekti i QKMF-së dhe objektet tjera shëndetësore në afërsi të sajë (QMF-të në qytet dhe fshatrat e afërta të komunës), dorëzohen në xhirollogarinë përkatëse në baza ditore. Për të gjitha këto epet dëshmi përmes të Ditarit të Arkës dhe i cili mund te verifikohet në Drejtorinë e QKMF-së, me anë të, të cilit, ne në baza ditore dorëzojmë mjete ne xhirollogarinë përkatëse. Sidoqoftë, ne do të i shqyrtojmë mundësitë që në të ardhmen të mos mbeten këto shuma për pa u dorëzua	
Çështja 11:		Lidhur me Memorandumin e Mirëkuptimit me European Kosova, bashkëngjitur mund të gjeni dokumentet që e sqarojnë këtë të gjetur, si: 1. Draft Buxheti E13, 2. E13 ko Gjakova, 3. European Press Release, 4. Memorandumi i mirëkuptimit 5. Takimet e Sekretariatit 6. Prezantimi para memorandumit Lidhur me Projektin “ Sanimi I Rrugës prej Qendrës Inovative (JIC) seri tek Lagja Mulla Isuf (sheshi Agron Rama) Drejtoria posedon këto dokumente:	Ne këto dokumente i kemi trajtuar në fazën e auditimit dhe konsideroj që ofrimi i dokumenteve të tilla nuk është i mjaftueshëm dhe e gjetura dhe konkluzioni ynë mbetet.

		1. Memorandum I Mirëkuptimit “ Planet Lokale te trashëgimisë Kulturore 2012-2015” te nënshkruar me date 01.10.2012 ne mes te :CHwB (drejtor z. Sali Shoshi); MKRS (Ministër z. Memli Krasniqi); MMPH (z. Ministër Dardan Gashi) dhe te Komunave : Gjakovë, Dragash, Gjiilan, Kaçanik, Partesh, Rahovec dhe Vushtrri – Kopja e nënshkruar është ne Drejtori për ZHE. SHPJEGIM: sipas Nenit 4 te MM “Përgjegjësitë e Palëve” , disa nga me te rëndësishmet janë: 1.1.1. CHwB, participon me 100,000 euro, - Siguron mbarëvajtjen e Programit përfshire hartimin e Planeve trashëgimore , - implementimin e disa aktiviteteve me prioritet, etj. 1.1.2. Komuna participon me ma se paku 20 % te vlerës se projekteve me prioritet 2. Marrëveshja e Bashkëpunimi ne mes te Komunës se Gjakovës (Kryetarja znj. Mimoza Kusari Lila); Fondacioni Bexhet Pacolli (z. Valon Lluka) dhe CHwB (Drejtori z. Sali Shoshi) , e nënshkruar me date 22.09.2014, lënda e protokolluar me numër 01-415-34408 ne Gjakove. Kopja e nënshkruar te MM është ne Drejtori te ZHE. 3. Vendimi për formimin e Komisionit për Pranim teknik, prej anëtareve: Selajdin Kumnova (kryetar I Komisionit nga QRTK); z. Nexhip Qehaja (anëtar, ing. ne Komune te Gjakovës ne DZHE) ; dhe Pjeter Marku (anëtar nga Komuna e Gjakovës, Drejtoria për Shërbime Publike). Vendimi numer06.nr zyrtar I protokolluar me 06-11.11.2014. Kopja e nënshkruar është ne drejtori te ZHE.	E gjetura është për marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 02.09.2014 e jo për memorandumin që ju e përmendeni. E gjetura tek çështja 11 mbetet e pandryshuar.
--	--	---	--

		4. Pranimi Teknik, nga Komisioni për pranim teknik I cekur nen piken 3, është bere me date 27.11.2014, kopja e nënshkruar është ne DZHE 5. Raportet e Punës: a) 22.09.2014, b) 17.10.2014 dhe c) raporti përfundimtar me 6.11.2014. Kopjet e nënshkruar janë ne Drejtori te ZHE. 6. Raportet e testimit te ngjashmërisë se rrugës, nga NSH"AL-ING", date 04.06.2014 dhe 29.08.2014 dhe 28.10.2014 Raportet e nënshkruara ne DZHE 7. Prokurimi Publik, është bere sipas rregullave te CHwB, qe janë te bashkangjitura ne fajlin ne attach. Te gjitha dokumente, qe kërkohen te nënshkruara janë ne fajl ne Drejtori për Zhvillim Ekonomik.	
--	--	--	--